



VENDIM

Nr. 7 Datë 24.01.2012

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE ME NR. 4168 PROT. DATE 30.12.2011 MIDIS OST SH.A
DHE RUDNAP ENERGY TIRANA SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, pikës 4.13 gërma “A” pika 3, pikës 7 gërma “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.01.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 4168 Prot., datë 30.12.2011, midis OST sh.a dhe Rudnap Energy Tirana sh.p.k,

Konstatohet se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a dhe Rudnap Energy Tirana sh.p.k janë subjekte të licensuara nga ERE respektivisht me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.03.2009, për aktivitetin e transmetimit dhe me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 20, datë 04.03.2011, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, te ndryshuar, si dhe me Vendimin e ERE-s nr. 146 date 07.12.2011 “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n ne cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë natyrë kontrate.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike me nr. 4168 Prot, date 30.12.2012, midis OST sh.a dhe Rudnap Energy Tirana sh.p.k, me ndryshimet si me poshtë:

Pikat 5.13 dhe 5.14 përpunohen si me poshtë :

Pika 5.13

Në rast kur Rudnap Energy Tirana sh.p.k nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës siç përcaktohet në pikën 5.14.

Pika 5.14

Pas kalimit të afatit të pagesës të caktuar ne pikën 5.8 të kësaj marrëveshje, Rudnap Energy Tirana sh.p.k është e detyruar ti paguajë OST sh.a një kamatëvonesë të barabartë me 120% e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë, që përcaktohet çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të tremujorit paraardhës”.

1. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI